

VENDIM 06-02/2011

Bazuar në nenin 36 paragrafi 1 nënparagrafi 1.17 dhe nenin 65 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-209 Për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimeve dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimeve, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 04 shkurt 2011 lëshon këtë:

UDHËZIM

Në zbatim të Rregullit 3 të Bankës Qendrore mbi Ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë, në mënyre të veçantë zbatimin e procedurave mbi mënyrën e shitjes së policave TPL përmes sistemit on-line dhe më qëllim të përcaktimit të procedurave të qasjes në sistemin on-line, të gjitha Kompanitë e Sigurimeve obligohen si me poshtë:

1. Përmes kompanisë së shërbimeve softuerike të implementojnë mekanizmin për kufizimin e përdorimit të terminaleve për shitjen e policave TPL në sistemin “on-line”. Një operator nuk mund të kryejë shitjen e policave të sigurimit nga më shumë se një terminal.
2. Ndalohet përdorimi i pajisjeve mobile për shitjen e policave TPL, veçanërisht laptopëve apo netbooks.
3. Ky Udhëzim fillon të zbatohet nga data 01 Mars 2011.
4. Sipas Ligjit për Bankën Qendrore Udhëzimet e nxjerra nga Banka Qendrore kanë aplikim të Përgjithshëm, janë të detyrueshme në tërësinë e tyre dhe drejtpërdrejtë të aplikueshme.

Gani GËRGURI

UD Guvernator

Kopje:

1. Kompanive të sigurimeve
2. Kompanisë softuerike
3. Shoqatës së Sigurimeve